REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVË-SKUPŠTINA OPŠTINE MALIŠEVO

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 13/10/2026
PRIMLJENO:
NR:PR:BR: 02/297

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr. 02/_____
Datë:30.09.2026

P r o c e s v e r b a l
i mbledhjes së -V- (pestë) urgjente e Komitetit për Politikë dhe Financa

Koha:30.09.2026 ora 14:00
Vendi:Salla e mbajtjes së takimeve të Komisioneve të Kuvendit Komunal të Malishevës
Të pranishëm:Kryesuesi i Kuvendit z.Fatmir Ademaj
Anëtarët e Komisionit për Politikë dhe Financa:Halil Morina,Edonë Hoti,Gentiana Mehemti,Imran Xhyliqi,Xheneta Morina,Veton Zogaj.
Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm :z.Arbër Kastrati.
Përfaqësues nga zyra e informimit z.Artan Paçarizi.

Mbledhjen e udhëheqi dhe e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj meqenëse konstatoi se korumi ishte i mjaftueshëm për mbajtjen e seancës e vuri në votim rendin e ditës si në vijimë:

Rendi i ditës

1.Shqyrtim dhe miratim i Draft Rregullores për taksa,tarifa dhe ngarkesa komunale.

Rendi i ditës u miratua unanimishtë nga të gjithë anëtarët e KPF-së.
Rezultati i votimit:7 për, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 1

Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtim dhe miratim i Draft Rregullores për taksa,tarifa dhe ngarkesa komunale.

Fatmir Ademaj(Kryesuesi i Kuvendit):Përshëndetje të nderuar anëtarë!Për sot e kemi vetëm një pikë të rendit të ditës.drejtorin e kemi prezent të cilit ja kalojë fjalën.
Arbër Kastrati(Drejtor për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm):Përshëndetje për të gjithë!Me propozimin e Drejtorisë dhe vendimin e Kryetarit ne e kemi themeluar komisionin për Hartimin dhe ndryshimin e Rregullores për taksa,tarifa dhe ngarkesa komunale për vitin 2027 me anë të kësaj Rrgullore komisioni i ka mbajtur disa mbledhje me të cilën i kanë hartuar disa ndryshime,përkatësishtë secili anëtarë për sektorin e tij e ka hartuar këtë draft,andaj kërkoj nga ju që këtë Rregullore ta propozoni për Kuvend.

Fatmir Ademaj(Kryesuesi i Kuvendit):Ju faleminderirt Drejtor.E hapi debatin për anëtarët e komisionit.

Halil Morina:Ky takim është urgjent,ne e kemi një kërkesë nga MAPL-ja që këtë vendim me harmonizuar me këtë Rregullore.A është vetëm ndryshimi për rregullimin e tarifave të mbeturinave apo edhe ndonjë ndryshim tjetër?

Arbër Kastrati(Drejtor për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm):Sa i përket tarifave të mbeturinave nuk ka të bëjë me këtë Rregullore.Kjo është ngarkesa që i bënë komuna ndaj bizneseve përkatësishtë për veprimtarin e tyre që e ushtrojnë në komunën e Malishevës.

Fatmir Ademaj(Kryesuesi i Kuvendit):Ky takim është thirrur shpejt për shkak të afatit kohor të limituar pasi ky takim ka qenë edhe në dëgjim publik deri më datën e sodit,pasi që kjo Rregullore trajtohet ngjajshëm me buxhetin dhe duhet deri në shtator të aprovohet.Meqenëse dje e kemi pasur senacën e rregullt të Kuvendit për votimin e buxhetit,mirëpo dëgjimi publik për Rregulloren,tarifat dhe ngarkesat komunale ka qenë edhe një ditë më shumë,pra deri më sot,prandaj ne rekomandum që sot ta mbajmë takimin e Komitetit për Politikë e Financa si dhe të Kuvendit,rrjedhimisht për aprovimin e kësaj Rregullore.

Halil Morina:Unë në këtë Rregullore e vura re që në Rregulloren e vitit të kaluar te neni 15 te pika 15.1 si dhe 15.2 Shfrytëzimi i përkohshëm i hapësirave publike(pishinave publike) më pak se një vit si dhe Shfrytëzimi i përkohshëm me ndërtime të forta për banim apo afarizëm një here kemi marrë vërejtje nga auditori,pikërisht me pishinën publike ka qenë fjala për pishinën e Banjës sepse komisioni atëherë ja ka dhënë me çmimin prej 3 euro për arsyeje sepse është llogaritur pa ndërtim të fortë,auditori e ka dhënë vërejtjen sepse ju nuk i keni ndarë këtë qështje dhe është dashur me vlerësuar me 4 euro,kurse unë mendoj që ne për ta arsyetuar vetën dhe vendimet që i ka marrë Kryetari jo më larg se një vitë te 15.1 do me thënë te shfrytëzimi i përkohshëm i hapsirave publike që nuk kanë ndërtim të fortë të mos jetë e njejtë 4 euro sikur kjo por të jetë 3 euro kurse pika 15.2 të mbetet e njejtë 4 euro,në mënyrë që në qfarë do tentative ti tregojmë auditorit që qëllimi jonë ka qenë kjo qështje që pastaj mos të kemi pasoja ligjore.Ky është ndryshimi i vetëm që une e kisha kërkuar me bërë.

Imran Xhyliqi:Unë e vura re te kjo Rregullore ndryshimin,te veprimtaria e shkollave për shofer nga 200 euro në shumën prej 300 euro.A është rritur kjo shumë Drejtor?Në qfarë kalkulime janë bazuar,nuk e kam të kjartë, për shembull frizer për meshkuj,këpuctar,oratorë,rrobaqepës nga 100 euro e keni bërë në shumën prej 200 euro,ndërsa në shërbime specialisitike në ordinanca private,bëhet fjala për mjek privat të cilët një visitë e kanë 30 euro ose 50 euro ju e keni lënë zero.Për mendimin tim kjo nuk ka kuptim sepse ne e dim që shumica e tyre nuk kanë TVSH,kurse qarkullimi i tyre është me mijra euro.

Arbër Kastrati(Drejtor për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm):Ne këtë material e kemi pasur për lektorim gjuhësor sepse me zero euro nuk ka mundësi me qenë,por atyre ju ka ikur kjo shumë me cekur.

Imran Xhyliqi:Kurse te Poliklinikat,qendrat diagnostike,laboratorët e analizave në shumën prej 200 euro e keni cekur.

Arbër Kastrati(Drejtor për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm):Shërbimet specialistike në ordinanca private,Poliklinikat,qendrat diagnostike,laboratorët e analizave janë në shumën prej 200 euro taksa vjetore vetëm se kjo shumë ka dalur në faqen tjetër kurse aty figuron me zero.Këto janë zakonisht kode të veprimtarisë që Ministria i përcaktonë dhe në bazë të ligjshmërisë komuna e hartonë draftin përmes atyre,pra komisioni është marrë me këtë punë.

Veton Zogaj:Unë e vërjeta që ka ndryshime drastike ky Draft nga i kaluari,ndoshta do të ishte mirë me pasur kohë me analizuar më detajisht sepse tani jemi para aktit final të saj.Unë jam marrë me dokumente e kam vërejtur që komuna jonë i ka disa tarifa më të larta në krahasim me komunat e tjera,përshembull te çertifikata shëndetësore për punsim është në shumën e vlerës prej 15 euro,realisht një person që është i papunësuar dhe kërkonë punë,do të ja pa mundësonë një aplikim kur e din që prodecurat rekrutuese për me fituar vendin e punës janë të vështira,ndoshta nuk aplikonë vetëm për shkak që i nevojitet një çertifikatë e tillë,çertifikatë shëndetësore për punsim në vendim e punës në kushte të veqanta punës është cekur në shumën prej 50 euro për shenbull nëse dikush dëshironë me u bërë drejtor 50 euro për një çertifikatë,pra vetëm një aplikim me dokumentet e tjera ka kosto të lartë,për mua është e pakuptim,janë cekur edhe disa shuma të tjera të cilat janë të larta duke e pasur parasysh gjendjen tonë aktuale.Ndoshta është edhe faji jonë që nuk kemi marrë pjesë në dëgjim publik dhe aty me i propozuarë mendimet tona.

Halil Morina:Do të ishte mirë me zgjatur edhe më shumë këtë takim në mënyrë që propozimet tona për ndryshim me i përfshirë në draft.

Fatmir Ademaj(Kryesuesi i Kuvendit):Atëherë kush jeni për që kjo të rekomandohet për Asamble komunale?
Rezultati i votimit:
Për 7,kundër 0,abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga anëtarët e komisionit për politikë dhe financa u miratua unanimisht Shqyrtim dhe miratim i Draft Rregullores për taksa,tarifa dhe ngarkesa komunale si dhe i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Punimet e mbledhjes përfunduanë në ora 14:00.

Malishevë,Shtator 2026

Procesëmbajtësja

Fatlume Delija

Kryesues i Kuvendit

Fatmir Ademaj